



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 12.7.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliçević

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Granit Berisha, praktikant, Egzon Pacolli, praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016;

Armend Zemaj, tha se kryetari të Komisionit për Buxhet dhe Financa i është shpjeguar arsyeja pse është kërkuar që të mbështeten kërkesat e Komisionit për Legjislacion për ndarjen e buxhetit për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Zemaj sqaroi se Komisioni për Buxhet dhe Financa do ti shqyrtojë këto kërkesa edhe pse vendimi që është marrë është vendosur që asnjë rekomandim, që vjen nga deputetët dhe komisionet, të mos përkrahet për arsye se prioritet iu është dhënë komunave të reja. Ndërsa, sa i përket nivelizimit të pagave, është kërkuar që të shikohet ligji i ri edhe pse është kërkuar që të bëhet nivelizimi i pagave, sidomos për Avokaturën e Shtetit, kur dihet se sa ka rëndësi Agjencia për Avokaturën e Shtetit, theksoi në fund deputeti Armend Zemaj.

Agim Aliu, tha se Komisioni për Buxhet ka pasur gatishmëri ti përkrahë kërkesat dhe rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni për Legjislacion, të cilat janë të domosdoshme kur dihet se janë edhe kategori kushtetuese, mirëpo, problemi qëndron te hapja e vendeve të reja të punës dhe mosakordimi me Fondin Monetar Ndërkombëtarë. Zotimet ishin se në vitin 2017, këto kërkesa do të jenë pjesë e buxhetit dhe do të realizohen kërkesat dhe rekomandimet që dalin nga Komisioni potencoi z. Agim Aliu.

Kryesuesja, në fjalën e saj tha se të gjitha kërkesat për buxhet shitesë nga organizatat të cilat raportojnë në Komisionin për Legjislacion, nuk janë aprovuar nga Komisioni për Financa për arsye se pse buxheti për këtë vit ishte shumë i ngarkuar dhe nuk ka pasur mundësi të bëhet lëvizje e buxhetit. Ajo tha se si Komision do të bëjmë presion të vazhdueshëm për buxhetin e vitit 2017, në mënyrë që këto kërkesa të realizohen.

Selvie Halimi, kryesuese, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016 dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje,

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund ti procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund ti procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi